



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 138/26 Dt. 26.03.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj njoftimit të publikuar nga Komisioni që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sipas shpalljes publike për ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve të komunikacionit urban, me nr. reference 05-343/16647, datë 06.02.2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Muhamet Bajrami,kryesues i komisionit,
 - 1.2. Agnesa Thaqi Kurejshi,anëtare,
 - 1.3. Laura Suka,anëtare.
2. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me shpalljen publike për ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve të komunikacionit urban, me nr. reference 05-343/16647, datë 06.02.2026, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

